



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Dukagjin PUPOVCI • Halim HYSENI • Jonuz SALIHAI

ARSIMI NË KOSOVË 2000/01

Prishtinë, dhjetor 2001

Botues:

Qendra për Arsim e Kosovës – Prishtinë

<http://www.kec-ks.org>

Për Botuesin:

Dukagjin Pupovci

Lektor:

Hasan Emërllahu

Ballina & Përgatitja teknike:

Ars Albanica

Shtypi:

Druck Art – Prishtinë

Botimin e këtij libri e ndihmuan:

Federal Minsitru for Foreign Affairs - Austria
Kosovar Foundation for Open Society (KFOS)
KulturKontakt AUSTRIA
Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC)

PARATHËNIE

Është ky viti i dytë me radhë që Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) paraqitet me një publikim ku prezantohen në mënyrë të përmbledhur të dhënat për arsimin në Kosovë. Meqë publikimi i vitit të kaluar me titullin *‘Shifra dhe fakte për Arsimin e Kosovës’* ka qenë i pari i këtij lloji dhe ka mbuluar një periudhë më të gjatë kohore, këtë herë jemi fokusuar në vitin shkollor 2000/01, duke u përpjekur të bëjmë krahasime me vitet e mëhershme sa herë që diç e tillë ka kuptim.

Edhe këtë vit jemi ballafaquar me probleme të natyrës teknike, të cilat kanë qenë një kufizim serioz për t’i prezantuar të dhënat në formën në të cilën kemi dëshiruar. Sistemi i mbledhjes, përpunimit dhe shfrytëzimit të të dhënave për arsimin në Kosovë për qëllime menaxhimi është në ndërtim e sipër, prandaj kemi arsye të shpresojmë se në të ardhmen e afërt metodologjia e mbledhjes dhe e përpunimit të të dhënave do të standardizohet. Nga ana tjetër, për shkak të kompetencave objektivist të kufizuara që kanë autoritetet arsimore të Kosovës ndaj mësimin në gjuhën serbe, të dhënat për këtë gjuhë mësimore janë të mangëta ose mungojnë plotësisht.

Të dhënat për arsimin parauniversitar na janë vënë në dispozicion nga Departamenti për Arsim dhe Shkencë i UNMIK-ut, falë mirëkuptimit të bashkëkryesuesit ndërkombëtar, z. Michael Daxner, ndërkohë që zyrtari i arsimit në këtë Departament, z. Fetah Bylykbashi ka qenë në dispozicion sa herë kemi pasur nevojë për ndonjë informacion plotësues. Ndërkaq, z. Halil Balaj nga Universiteti i Prishtinës na ka ofruar ndihmë të çmueshme në lidhje me të dhënat për arsimin e lartë. Shfrytëzoj rastin që të gjithëve të ju shpreh falenderime të sinqerta.

Prishtinë, 29 dhjetor 2001

Dukagjin PUPOVCI

PËRMBAJTJA

1. KONTEKSTI NACIONAL	7
1.1. Konteksti gjeografik	7
1.2. Konteksti social	7
1.3. Konteksti politik	8
2. SISTEMI I ARSIMIT	9
2.1. Struktura e sistemit	9
2.2. Qeverisja dhe menaxhimi	11
3. EDUKIMI PARASHKOLLOR	13
3.1. Vërejtje të përgjithshme	13
3.2. Rrjeti i institucioneve parashkollore	13
3.3. Personeli mësimor-edukativ	16
4. ARSIMI FILLOR	19
4.1. Vërejtje të përgjithshme	19
4.2. Rrjeti i shkollave fillore	19
4.3. Nxënësit në arsimin fillor	24
4.4. Personeli mësimor-edukativ në arsimin fillor	29
4.5. Lokali shkollor	40
5. ARSIMI I MESËM	43
5.1. Vërejtje të përgjithshme	43
5.2. Rrjeti i shkollave të mesme	43
5.3. Nxënësit në arsimin e mesëm	45
5.4. Personeli mësimor-edukativ në arsimin e mesëm	51
5.5. Lokali shkollor	55
6. ARSIMI I LARTË	58
6.1. Vërejtje të përgjithshme	58
6.2. Rrjeti i institucioneve të arsimit të lartë	58
6.3. Studentët	59
6.4. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët	63
7. REZYME	67

1. KONTEKSTI NACIONAL

1.1. Konteksti gjeografik

Kosova ka një sipërfaqe prej 10,887 km² dhe shtrihet në një territor me lartësi mesatare mbidetare prej 500 m, të rrethuar nga malet dhe të ndarë sipas një vije veri-jug në dy regjione përafërsisht të njëjta përkrah madhësia dhe numri i banorëve.



Edhe pse të dhënat e sakta demografike nuk ekzistojnë, në bazë të të dhënave të UNMIK-ut dhe IOM-it të gushtit të vitit 2000, si dhe në bazë të të dhënave të Entit të Statistikës të Kosovës, vlerësohet se në Kosovë, për momentin jetojnë 1.8-2 milionë qytetarë, prej të cilëve rreth 60% janë më të ri se 25 vjet. Vlerësohet se 90% të popullatës kosovare e përbëjnë shqiptarët, 7% serbët, ndërsa 3% malazezët, boshnjakët, turqit, romët dhe grupet tjera etnike.

Kosova është e ndarë në 30 komuna me rreth 1,500 vendbanime. Si e tillë paraqet një vend rural me 2/3 e popullatës që jetojnë nëpër fshatra dhe ka 9 qytete me më shumë se 20,000 banorë.

1.2. Konteksti social

Vlerësimet zyrtare tregojnë se në periudhën e paraluftës, të ardhurat nacionale (GDP) për kokë banori ishin 400 USD, mirëpo këtu nuk është përfshirë një pjesë e mirë e ekonomisë

së atëherëshme kosovare. Edhe pse aktiviteti ekonomik në Kosovën e pasluftës ka shënuar rezultate të mira, falë investimeve të shtuara të kapitalit, dëmi që i është shkaktuar ekonomisë në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX paraqet pengesë serioze për zhvillimin ekonomik dhe kushtëzon një shkallë mjaft të madhe të papunësisë. Faktorë të tjerë që ndikojnë në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik janë gjendja jo e mirë e infrastrukturës, gjendja e vështirë energjetike dhe akumulimi i varfëruar i kapitalit.

Pasojat e konfliktit janë ende të dukshme në Kosovë. Shumë familje janë të zhvendosura, pa kulm mbi kokë ose në kërkim të anëtarëve të zhdukur gjatë luftës. Urrejtja ndëretnike në mes të shqiptarëve dhe serbëve është ende e pranishme, dhe, për shkaqe sigurie, pjesa më e madhe e popullatës serbe jeton nëpër enklava nën mbrojtjen e KFOR-it, ose në pjesën e Kosovës në veri të lumit Ibër.

1.3. Konteksti politik

Prania e UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë shihet nga popullata shumicë shqiptare si një fazë tranzicioni drejt Kosovës së pavarur, ndërkaq popullata serbe e konsideron këtë fakt si okupim të vendit të vet. Përveç konfliktit të vitit 1999, kjo kundërshti paraqet gjeneratorin kryesor të tensioneve në mes të dy komuniteteve. Zgjedhjet lokale në Kosovë të mbajtura në tetor të vitit 2000, ishin hapi i parë drejt krijimit të institucioneve të vetëqeverisjes lokale, edhe pse fillimisht u bojkotuan nga popullata serbe.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme, e cila u aprovua në maj të vitit 2001, paraqet dokumentin bazë juridik të Kosovës, mbi të cilin mbështetet zhvillimi demokratik dhe civil i saj. Pritet që zgjedhjet nacionale, të cilat u mbajtën në nëntor të vitit 2001, të kontribuojnë në demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë kosovare, duke i shërbyer uljes së tensioneve ndëretnike dhe, në një të ardhme jo të largët, krijimit të një shoqërie multi-etnike dhe multikulturore.

2. SISTEMI I ARSIMIT

2.1. Struktura e sistemit


Një veçori karakteristike të arsimit në Kosovë paraqet ekzistimi i dy sistemeve paralele që nga vitit 1991. Në periudhën e pasluftës janë të pranishëm sistemi kosovar i arsimit, i cili njih autoritetin e UNMIK-ut dhe përfshin mësimin në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke, si dhe sistemi serb i arsimit, i cili njih autoritetin e organeve të Serbisë dhe përfshin mësimin në gjuhën serbe. Me gjithë hapat pozitivë që janë bërë në vitin e fundit drejt integritetit të komunitetit serb në një sistem unik të arsimit, mund të thuhet se kjo çështje është ende tejet e politizuar dhe duhet të vështrohet në kontekst më të gjerë politik.



Skema 1. Struktura ekzistuese dhe e re e arsimit parauniversitar në Kosovë

Struktura e tanishme e të dy sistemeve parauniversitare të arsimit që funksionojnë në Kosovë është shumë e ngjashme dhe buron nga periudha e viteve të nëntëdhjeta të shek. XX. Kjo strukturë parasheh 8 vjet të arsimit të detyrueshëm. Ndërkaq, struktura e re e sistemit të arsimit parasheh 9 vjet të shkollimit të detyrueshëm (5 vjet të arsimit fillor dhe 4 vjet të arsimit të ulët të mesëm). Skema 1 jep një krahasim në mes të sistemit ekzistues dhe atij të ri të arsimit parauniversitar.

Edhe pse dy sistemet ekzistuese të arsimit të lartë në Kosovë karakterizohen me një trashëgimi të përbashkët, ato megjithatë kanë dallime më të mëdha njëri prej tjetrit se sa sistemet parauniversitare, e tërë kjo si rezultat i legjislaturës nga kjo lëmi që u aprovua nga organet e Kosovës dhe Serbisë në vitet e nëntëdhjeta. Arsimi i lartë në Kosovë synohet të reformohet në frymën e Deklaratës së Bolonjës të vitit 1999, e cila duhet të shërbejë si një agjendë afatgjatë për ndryshime strukturale në arsimin e lartë në vendet evropiane, duke promovuar mobilitetin, mundësitë e shtuara për punësim dhe atraktivitetin e programeve në institucionet e arsimit të lartë.



Skema 2. Struktura e tanishme dhe e planifikuar e sistemit të arsimit të lartë

2.2. Qeverisja dhe menaxhimi


Departamenti për Arsim dhe Shkencë (DASH) i UNMIK-ut është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin në Kosovë. Megjithatë ekziston një koncept i decentralizimit të qeverisjes dhe menaxhimit të arsimit në Kosovë, ende nuk është bërë një ndarje përfundimtare e kompetencave dhe përgjegjësi në mes të DASH dhe autoriteteve komunale që janë emëruar pas zgjedhjeve lokale.

DASH ushtron funksionin e vet qeverisës dhe koordinues përmes zyrës qendrore në Prishtinë, pesë zyrave regjionale: në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë dhe Prizren, si dhe drejtorive administrative të arsimit (DAA) të themeluara nga DASH në çdo komunë të Kosovës. Ndërkaq, autoritetet komunale të dala nga zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2000, kanë themeluar drejtoritë komunale të arsimit (DKA), si organe që ushtrojnë funksionet e vetëqeverisjes lokale në fushën e arsimit. Udhëzimi Administrativ i DASH nr. 2001/12 ka përcaktuar një ndarje të kompetencave në mes të DAA-ve dhe DKA-ve (shih skemën 3).

Me qëllim të reformimit të segmenteve të caktuara të sistemit të arsimit, DASH ka emëruar disa agjenci udhëheqëse, të cilat, në të vërtetë janë bartësit e projekteve të caktuara të donatorëve ndërkombëtarë që kanë për qëllim intervenimin në fusha të ndryshme të sistemit të arsimit. Këto agjenci udhëheqëse kanë për detyrë që të zhvillojnë kapacitetin lokal në fushat e tyre të veprimit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe diseminimi i rezultateve të projekteve që janë në implementim e sipër. Të njëjtat agjenci duhet të jenë edhe bartës të ndryshimeve në fushën e intervenimit të tyre, ndërsa do të duhej të ekzistonte edhe një mekanizëm koordinues në mes tyre. Deri tani janë emëruar agjenci udhëheqëse në këto fusha:

1. Zhvillimi i kurrikulave – UNICEF
2. Edukimi parashkollor – UNICEF
3. Trajnimi i mësimitdhënësve – Qeveria e Kanadasë
4. Arsimi Special – Qeveria e Finlandës
5. Arsimi profesional – Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ)

Në strukturën e tanishme qeverisëse të sistemit të arsimit në Kosovë, disa sektorë menaxhohen drejtëpërdrejtë nga DASH: arsimi i lartë, arsimi i mesëm, arsimi special, edukimi parashkollor, etj. Ndërkaq, si detyrë ekskluzive e DAA-ve shihet implementimi i politikave të DASH, përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e kurrikulit, vlerësimin e nxënësve dhe shkollës, metodologjitë e mësimitdhënies, punësimin dhe pushimin nga puna të punëtorëve të arsimit, ndërkohë që përgjegjësi primare e DKA-ve është menaxhimi i resurseve materiale, shërbimeve ndihmëse të shkollës, përkujdesja për transportin e nxënësve, e të ngjashme.



Skema 3. Skema e qeverisjes të sistemit të arsimit në Kosovë

3. EDUKIMI PARASHKOLLOR

3.1. Vërejtje të përgjithshme

Edukimi parashkollor paraqet nivelin më pak të zhvilluar të sistemit të arsimit në Kosovë. Mungesa e një rrjeti të mirëfilltë të institucioneve të edukimit parashkollor, si dhe mungesa e një tradite të favorshme bëjnë që ngecjet në këtë sektor të jenë të parashikueshme. Të gjitha studimet komparative tregojnë se, në aspektin e zhvillimit të edukimit parashkollor, Kosova zë vendin e fundit në Ballkan.

Sistemi i edukimit parashkollor ndahet në tri nivele:

- Çerdhja (për fëmijët e moshës 1-2 vjeçare)
- Kopshti (për fëmijët e moshës 3-4 vjeçare)
- Klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5 vjeçare)

Qëllimi kryesor i **çerdhes** është përkujdesja dhe mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve, formimi i shprehive higjienike, përfitimi i aftësive bazike të të folurit, etj. Në **kopshte** qëllim kryesor është zhvillimi i aftësive dhe i operacioneve mendore, zhvillimi i imagjinatës, formimi i shprehive higjienike dhe shprehive të sjelljeve sociale, formimi i koncepteve elementare gjuhësore e matematikore, njohja me mjedisin, zhvillimi i ndjenjës dhe aftësive shprehëse muzikore dhe figurative, zhvillimi i shprehive shëndetësore si dhe zhvillimi fizik nëpërmjet lojës. Në **klasën parafillore** fëmijët duhet të aftësohen për nxënien e përmbytjeve të ngjashme me ato të shkollës fillore, përfshirë elemente themelore të leximit, shkrimit, numërimit dhe kalkulimit.

Edukimi parashkollor zhvillohet në institucione të specializuara publike dhe private, ku për fëmijët rëndom organizohet qëndrimi tërëditor. Fëmijët janë të ndarë në grupe prej 15-30. Ndërkaq, klasët parashkollore, si rregull, organizohen pranë shkollave fillore.

Në institucione të edukimit parashkollor me fëmijë punojnë edukatorët, të cilat duhet të kenë kualifikimin përkatës – grupin për edukatore të shkollës së lartë ose thirrjen universitare nga pedagogjia. Sidoqoftë, në mungesë të kuadrit të kualifikuar këtë profesion e ushtrojnë edhe motra medicinale dhe mësuese të profileve të tjera.

3.2. Rrjeti i institucioneve parashkollore


Tabela 3.2.1. Numri i institucioneve parashkollore, grupeve dhe fëmijëve në institucionet parashkollore sipas komunave

Nr.	Komuna	Nr. i inst.	Çerdhe		Kopshte		Gjithsej	
			Grupe	Fëmijë	Grupe	Fëmijë	Grupe	Fëmijë
3	Ferizaj	1	3	66	5	133	8	199
4	Fushë-Kosovë	1	5	55	4	78	9	133
5	Glogoc	1	3	26	6	62	11	88
6	Gjakovë	2	15	194	17	526	32	720
7	Gjilan	2	3	54	7	189	10	243
8	Istog	1	2	23	6	57	8	80
9	Kaçanik	1	2	10	9	193	11	203
11	Kamenicë	1	1	14	3	60	4	74
12	Klinë	1	1	14	3	37	4	51

Nr.	Komuna	Nr. i inst.	Çerdhe		Kopshte		Gjithsej	
			Grupe	Fëmijë	Grupe	Fëmijë	Grupe	Fëmijë
13.	Lipjan	1	1	12	3	73	4	85
14.	Mitrovicë	1	6	85	6	188	12	273
16.	Obiliq	1	1	17	2	51	3	68
17.	Pejë	1	7	180	9	330	16	510
18.	Podujevë	1	3	22	3	46	6	68
20.	Prishtinë	1	27	594	33	1010	60	1604
21.	Prizren	1	8	74	4	190	12	264
22.	Rahovec	1	0	0	4	70	4	70
23.	Skënderaj	1	3	25	3	73	6	98
24.	Suharekë	1	1	12	3	103	4	115
27.	Viti	1	1	16	2	40	3	56
28.	Vushtrri	1	4	86	5	136	9	222
Gjithsej:		23	97	1579	137	3645	236	5224

Burimi: Raportet e institucioneve parashkollore dërguara DASH
Mungojnë të dhënat për institucionet parashkollore në gjuhën serbe

Harta 3.2.1. Harta e institucioneve parashkollore të Kosovës



Të dhënat e prezantuara në tabelën 3.2.1 krahasuar me të dhënat e gjendjes së institucioneve parashkollore në vitin shkollor 1999/2000 flasin për avancime dhe përparime të arritura gjatë vitit 2000/2001. Në vitin shkollor për fëmijët e bashkësisë etnike shqiptare, boshnjake dhe turke kanë qenë gjithsej 18 institucione parashkollore ndërsa tani janë 23. Ndërkaq, numri i fëmijëve është shtuar prej 4,624 në 5,224.

Tabela 3.2.2. Numri i grupeve dhe fëmijëve në klasën parafillore sipas komunave

Nr	Komuna	Grupe	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Deçan	15	214	204	418
2	Dragash	2	16	25	41
3	Ferizaj	45	668	630	1298
4	Fushë-Kosovë	3	37	40	77
5	Glogoc	18	232	244	476
6	Gjakovë	12	237	211	448

Nr	Komuna	Grupe	Meshkuj	Femra	Gjithsej
7	Gjilan	35	640	668	1,308
8	Istog	1	29	21	50
9	Kaçanik	13	189	176	365
10	Kamenicë	15	238	193	431
11	Klinë	10	143	137	280
13	Lipjan	30	329	334	663
14	Malishevë	26	392	334	726
16	Obiliq	12	121	92	213
17	Pejë	13	177	229	406
18	Podujevë	20	252	230	482
19	Prishtinë	10	145	160	305
20	Prizren	36	530	511	1041
21	Rahovec	16	272	299	571
22	Skënderaj	18	228	256	484
23	Suharekë	20	288	270	558
25	Shtime	13	155	171	326
26	Viti	17	293	281	574
27	Vushtrri	2	16	15	31
	Gjithsej	402	5,841	5,731	11,572

Nga tabela 3.2.2 mund të konstatohet se përfshirja e femijëve në klasën parafillore ka shënuar një rritje prej 56.8% në krahasim me vitin shkollor 1999/2000 kur në këtë nivel të arsimit ishin të përfshirë 7,379 fëmijë. Megjithatë vërehet se përfshirja e grupmoshës në këtë nivel është vetëm 24.5% të fëmijëve që regjistrohen në klasën e parë të shkollës fillore. Struktura gjinore e fëmijëve në klasën parafillore (50.5% meshkuj dhe 49.5% femra) është relativisht e ekuilibruar dhe pasqyron strukturën demografike të Kosovës,

3.3. Personeli mësimor-edukativ

Në edukimin parashkollor në Kosovë haset një diversitet profilesh të ndryshme të të punësuarve. Personelin edukativ-arsimor në çerdhe dhe kopshte të Kosovës e përbëjnë 381 punëtorë, prej të cilave 51 janë të pakualifikuara (shih tabelën 3.3.1). Ndërkaq, në klasët parafillore kanë qenë të angazhuar 393 mësimdhënës, prej të cilëve rreth 50.6% nuk kanë kualifikim përkatës.

Tabela 3.3.1. Personeli mësimor-edukativ në çerdhe dhe kopshte, sipas niveleve dhe komunave

Nr.	Komuna	Çerdhe		Kopshte		Çerdhe+Kopshte	
		Gjithsej	Pakual.	Gjithsej	Pakual.	Gjithsej	Pakual.
3	Ferizaj	12	0	8	0	20	0
4.	Fushë-Kosovë	1	0	4	4	5	4
5.	Gllgoc	5	0	6	1	11	1
6.	Gjakovë	28	0	17	4	45	4
7.	Gjilan	2	0	19	0	21	0
8.	Istog	2	0	2	1	4	1
9.	Kaçanik	2	0	5	1	7	1

Nr.	Komuna	Çerdhe		Kopshte		Çerdhe+Kopshte	
		Gjithsej	Pakual.	Gjithsej	Pakual.	Gjithsej	Pakual.
11	Kamenicë	1	0	5	1	6	1
12.	Klinë	2	0	3	3	5	3
13	Lipjan	2	0	3	0	5	0
14.	Mitrovicë	16	0	15	3	31	3
16.	Obiliq	2	0	4	4	6	4
17.	Pejë	11	0	19	0	30	0
18.	Podujevë	3	0	2	0	5	0
20.	Prishtinë	56	0	67	8	123	8
21.	Prizren	7	0	14	6	21	6
22.	Rahovec	0	0	1	1	1	1
23.	Skënderaj	1	0	3	1	4	1
24.	Suharekë	1	0	7	4	8	4
27	Viti	1	0	4	0	5	0
28.	Vushtrri	3	0	15	9	18	9
Gjithsej:		158	0	223	51	381	51

4. ARSIMI FILLOR

4.1. Vërejtje të përgjithshme

Me strukturën e tanishme të sistemit të arsimit, arsimi fillor në Kosovë është i obligueshëm dhe zgjatë 8 vjet. Arsimi fillor ndahet në dy cikle. Cikli i ulët (ISCED 1) përfshin klasët prej 1-4 dhe vijohet nga fëmijët e moshës 7-11 vjeçare. Si rregull, mësimdhënia në këtë cikël zhvillohet nga një mësues, përveç në raste të jashtëzakonshme kur mësimdhënia nga disa lëndë të shkathtësisë dhe të artit (edukata fizike, arti figurativ, arti muzikor) mund të mbahet nga arsimtarë lëndorë. Ndërkaq, cikli i lartë (ISCED 2A) përfshin klasët 5-8 dhe fëmijët e moshës 12-15 vjeçare. Cikli i lartë bazohet në mësimdhënien lëndore.

Sipas strukturës së re të sistemit të arsimit në Kosovë (shih skemën 1), arsimi fillor do të jetë 5-vjeçar, ndërsa pritet që kjo risi të aplikohet që nga viti shkollor 2002/03.

4.2. Rrjeti i shkollave fillore

Edhe pse në Kosovë nuk ka standarde dhe kritere të definuara për ndërtimin e një rrjeti funksional të shkollave fillore, ekziston një kriter ligjor, sipas të cilit distanca më e gjatë nga vendbanimi i nxënësit deri tek shkolla më e afërt nuk duhet të jetë mbi 5 km. Me qëllim të racionalizimit financiar dhe të zvoglimit të stafit administrativ shkollat fillore janë organizuar si shkolla qendrore dhe shkolla satelite. Shkollat satelite mund të jenë shkolla tetëklasëshe, shtatëklasëshe, gjashtëklasëshe, pesëklasëshe, katërklasëshe dhe shkolla me paralele kolektive. Paralelet kolektive përbëhen nga dy e më shumë klasë. Këto mund të jenë të kombinuara dhe të pandara. Paralelet e kombinuara përbëhen prej dy ose tri klasësh. Një paralele mund të ketë dy ose tri klasë me të cilat përnjëherë në një mësonjëtoare punon një mësues. Kombinimi i klasave mund të jetë i ndryshëm dhe varet nga numri i nxënësve. Kombinimi mund të jetë: I,II,III; II,III,IV; I,III,IV. Paralelet që përbëhen prej dy klasave kanë poashtu kombinime të ndryshme. I,II dhe III,IV; I,III dhe II,IV dhe I,IV dhe II,III. Kombinimi më i shpeshtë është I-III dhe II-IV. Ndërkaq, në paralelet e pandara një mësues punon me nxënësit e klasës I-IV.

Në shkollat kosovare mësimi zhvillohet në 5 gjuhë: shqip, serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe kroatisht.

Tabela 4.2.1. Harta e shkollave fillore sipas gjuhëve mësimore – shkollat qendrore

Nr	Komuna	Një gjuhë mësimore						Më shumë gjuhë mësimore						TOTAL
		Shqip	Sërbisht	Boshnj.	Turqisht	Kroatisht	Gjithsej	SH+B+T	SH+S	SH+B	SH+T	Sh+K	Gjithsej	
1.	Deçan	15	0	0	0	0	15	0	0	0	0	0	0	15
2.	Dragash	6	0	4	0	0	10	0	0	2	0	0	2	12
3.	Ferizaj	22	0	0	0	0	22	0	0	0	0	0	0	22
4.	Fushë-Kosovë	6	2	0	0	0	8	0	0	0	0	0	0	8
5.	Gllugoc	21	0	0	0	0	21	0	0	0	0	0	0	21
6.	Gjakovë	36	0	0	0	0	36	0	0	0	0	0	0	36
7.	Gjilan	17	8	0	0	0	25	0	0	0	2	0	2	27
8.	Istog	10	0	1	0	0	11	0	0	0	0	0	0	11
9.	Kaçanik	12	0	0	0	0	12	0	0	0	0	0	0	12
10.	Kamenicë	12	5	0	0	0	17	0	0	0	0	0	0	17
11.	Klinë	14	0	0	0	0	14	0	0	0	0	0	0	14
12.	Leposaviq	0	2	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
13.	Lipjan	16	3	0	0	1	20	0	0	0	0	0	0	20
14.	Malishevë	19	0	0	0	0	19	0	0	0	0	0	0	19
15.	Mitrovicë	24	10	0	0	0	34	0	0	1	1	0	2	36
16.	Novobërdë	2	3	0	0	0	5	0	0	0	0	0	0	5
17.	Obiliq	5	3	0	0	0	8	0	0	0	0	0	0	8
18.	Pejë	25	1	0	0	0	26	0	0	2	0	0	2	28
19.	Podujevë	29	0	0	0	0	29	0	0	0	0	0	0	29
20.	Prishtinë	32	4	0	0	0	36	0	0	1	1	0	2	38
21.	Prizren	25	0	4	0	0	29	3	0	5	3	0	11	40
22.	Rahovec	16	4	0	0	0	20	0	0	0	0	0	0	20
23.	Skënderaj	19	1	0	0	0	20	0	0	0	0	0	0	20
24.	Suharekë	22	0	0	0	0	22	0	0	0	0	0	0	22
25.	Shtërpçë	1	3	0	0	0	4	0	0	0	0	0	0	4
26.	Shtime	7	0	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0	7
27.	Viti	14	3	0	0	0	17	0	0	0	0	1	1	18
28.	Vushtrri	20	5	0	0	0	25	0	0	0	0	0	0	25
29.	Zubin Potok	1	2	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	3
30.	Zveçan	0	2	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
	Gjithsej	448	61	9	0	1	519	3	0	11	7	1	22	541

Nga tabela 4.2.1 shihet se mësimi në gjuhë shqipe zhvillohet në 470 shkolla kosovare (86.9% nga numri i shkollave), mësimi në gjuhën serbe në 61 shkolla (11.3%), mësimi në gjuhën boshnjake në 23 shkolla (4.3%), mësimi në gjuhën turke në 10 shkolla (1.8%), ndërsa mësimi në gjuhën kroate në 2 shkolla (0.37%) – shih grafiku 4.2.1. Nga këto të dhëna është e evidente se struktura gjuhësore e shkollave në Kosovë i përgjigjet përafërsisht strukturës etnike të popullatës.

Grafiku 4.2.1. Numri i shkollave fillore sipas gjuhëve mësimore në Kosovë




Tabela 4.2.2. Numri i shkollave fillore përfshirë edhe shkollat satelite¹

Nr.	Komuna	Shkolla qendrore	Shkollat satelite			Gjithsej shkolla
			4-8 klasë	Me paralele kolektive	Gjithsej	
1.	Deçan	15	4	1	5	20
2.	Dragash	12	0	22	22	34
3.	Ferizaj	22	8	11	19	41
4.	Fushë-Kosovë	6	12	1	13	19
5.	Glllogoc	21	3	0	3	24
6.	Gjakovë	36	0	5	5	41
7.	Gjilan	19	12	10	22	41
8.	Istog	10	5	2	7	17
9.	Kaçanik	12	14	7	21	33
10.	Kamenicë	12	3	12	15	27
11.	Klinë	14	9	1	10	24
13.	Lipjan	17	15	11	26	43
14.	Malishevë	19	14	1	15	34
15.	Mitrovicë	26	5	8	13	39
16.	Novobërdë	2	0	2	2	4
17.	Obiliq	5	8	1	9	14
18.	Pejë	27	10	3	13	40
19.	Podujevë	29	22	4	26	55
20.	Prishtinë	34	14	10	24	58
21.	Prizren	40	20	6	26	66
22.	Rahovec	16	11	2	13	29
23.	Skënderaj	19	9	2	11	30
24.	Suharekë	22	9	6	15	37
25.	Shtërpcë	1	3	2	5	6
26.	Shtime	7	10	1	11	18
27.	Viti	14	15	5	20	34
28.	Vushtrri	20	14	6	20	40
29.	Zubin Potok	1	0	0	0	1
	Gjithsej	478	245	142	391	869

¹ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Nga tabela 4.2.2 është e qartë se shkollimi fillor në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe kroate zhvillohet në 869 njësi organizative, prej të cilave 478 ose 55% janë shkolla qendrore dhe 391 ose 45% shkolla satelite. Nëse kësaj i shtohen 61 shkolla qendrore ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe, del se numri i përgjithshëm i njësive organizative të arsimit fillor është të paktën 930, që është diç më shumë se në vitin shkollor 1999/2000, kur numri i njësive organizative ishte 919.

Harta 4.2.1. Harta e shkollave fillore në Kosovë




Tabela 4.2.3. Numri i paraleleve në arsimin fillor sipas klasave dhe komunave²


Nr.	Komuna	Numri i paraleleve sipas klasëve									Gjithsej		
		I	II	III	IV	PK ³ (I-IV)	V	VI	VII	VIII	I-IV	V-VIII	I-VIII
1	Deçan	44	43	29	37	1	36	34	34	33	154	137	291
2	Dragash	43	29	29	27	22	31	29	30	24	150	114	264
3	Ferizaj	106	82	82	76	11	78	75	77	72	357	302	659
4	Fushë-Kosovë	22	22	18	20	1	19	21	21	18	83	79	162
5	Glllogoc	67	48	49	54	0	47	46	52	48	218	193	411
6	Gjakovë	83	81	78	80	14	76	73	74	72	336	295	631
7	Gjilan	93	77	72	67	28	68	68	70	66	337	272	609
8	Istog	42	35	35	30	8	31	31	32	31	150	125	275
9	Kaçanik	48	34	38	36	21	37	37	34	33	177	141	318
10	Kamenicë	40	27	27	27	19	29	28	25	26	140	108	248
11	Klinë	44	43	32	37	1	35	32	35	32	157	134	291
13	Lipjan	62	48	44	49	20	43	44	43	42	223	172	395
14	Malishevë	69	58	56	55	2	51	47	48	44	240	190	430
15	Mitrovicë	66	63	58	61	22	58	62	59	59	270	238	508
16	Novobërdë	2	2	2	2	4	2	2	2	2	12	8	20
17	Obiliq	20	16	18	17	5	15	15	16	18	76	64	140
18	Pejë	88	74	68	76	15	73	67	70	68	321	278	599
19	Podujevë	94	75	77	73	23	78	75	81	71	342	305	647
20	Prishtinë	152	135	127	126	35	131	134	127	129	575	521	1,096
21	Prizren	155	134	124	129	14	126	124	127	120	556	497	1,053
22	Rahovec	58	55	43	47	4	43	41	40	39	207	163	370
23	Skënderaj	57	54	45	52	6	52	48	48	43	214	191	405
24	Suharekë	73	58	54	57	12	59	56	57	53	254	225	479
25	Shtërpcë	2	2	2	2	5	3	3	3	3	13	12	25
26	Shtime	35	27	21	22	8	22	23	22	22	113	89	202
27	Viti	50	42	44	40	8	38	37	38	34	184	147	331
28	Vushtrri	69	56	57	57	11	55	52	55	51	250	213	463
29	Zubin Potoku	1	1	1	1	0	1	1	1	1	4	4	8
	Gjithsej	1,685	1,421	1,330	1,357	320	1,337	1,305	1,321	1,254	6,113	5,217	11,330

Nga tabela 4.2.3 dhe grafiku 4.2.2 shihet se numri i paraleleve të klasës së parë është dukshëm më i madh se sa paralelet e klasëve të tjera. Kjo mund të shpjgohet me faktin se në vitin shkollor 2000/01 ka filluar zbatimi i Rregullores 2000/51 sipas të cilës regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore bëhet në moshën 6-vjeçare, e jo në moshën 7-vjeçare siç është vepruar deri në vitin shkollor 1999/2000. Ndërkaq, numri më i vogël, por relativisht i balansuar i paraleleve të klasëve III-VIII mund të jetë rezultat i situatës së vështirë politike në vitet e nëntëdhjeta, e cila kulminoi me luftë.


² Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhë serbe

³ PK-Paralelet kolektive

Grafiku 4.2.2. Numri i paraleleve në arsimin fillor sipas klasave⁴



Grafiku 4.2.3. Numri i paraleleve sipas cikleve⁵



4.3. Nxënësit në arsimin fillor

Krahasuar me vitet e kaluara shkollore të dhjetëvjetëshit të fundit kur fillon rënia rapide e numrit të nxënësve në arsimin fillor në Kosovë, vitit shkollor 2000/01 karakterizohet me një shtim të konsiderueshëm të numrit të nxënësve. Përveç vendimit administrativ për regjistrimin e fëmijëve të moshës 6-vjeçare në klasën e parë të shkollës fillore, faktor tjetër që ka ndikuar në këtë shtim është krijimi i një klime të konsoliduar demokratike në Kosovë.

Të dhënat për vitin shkollor 2000/01 me të cilat disponon Departamenti për Arsim dhe Shkencë nuk bëjnë të mundur elaborimin e plotë dhe me saktësi të domosdoshme të strukturës gjuhësore dhe etnike të nxënësve në arsimin fillor, gjë që posaçërisht ka të bëjë me mësimin në gjuhën serbe. Për këtë arsye, për analizën e kësaj strukture janë shfrytëzuar të dhëna aproksimative, të cilat janë shumë të përafërta me gjendjen faktike.

Sipas të dhënave të sakta, në paralelet me mësim në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe kroate mësimin e vijnë 289,507 nxënës. Ndërkaq, sipas të dhënave të rezumuara të Departamentit për Arsim dhe Shkencë, mësimin në gjuhën serbe e vijnë 14,005 nxënës,

⁴ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

⁵ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

që d.m.th. se numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore të Kosovës është 303,512. Tabela 4.3.1 dhe grafiku 4.3.1 japin një pasqyrë të numrit të nxënësve sipas gjuhëve mësimore.

Tabela 4.3.1. Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas gjuhëve mësimore (vlerësim)

Mësimi në gjuhën shqipe	282,482
Mësimi në gjuhën serbe	14,005
Mësimi në gjuhën boshnjake	5,013
Mësimi në gjuhën turke	2,058
Mësimi në gjuhën kroate	32
Gjithsej	303,590

Grafiku 4.3.1. Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas gjuhëve mësimore (vlerësim)




Tabela 4.3.2 dhe grafiku 4.3.2 tregojnë lëvizjet në numrin e nxënësve sipas gjuhëve mësimore në tridhjetë vitet e fundit. Vërehet rritje e numrit të nxënësve në mësimin në gjuhën shqipe dhe zvogëlim i numrit të nxënësve në mësimin në gjuhën serbe, gjë që është pasojë e ndryshimeve në strukturën demografike të Kosovës, ndërsa pas vitit 1999 rezultat i shpërnguljes masive të popullatës serbe nga pjesa më e madhe e territorit të Kosovës.

Tabela 4.3.2. Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas viteve dhe gjuhës mësimore

Viti shkollor	Numri i nxënësve sipas gjuhëve mësimore					
	Shqip	Serbisht	Turqisht	Boshnj.	Kroatisht	Gjithsej
1970/71	172,212	64,856	2,325			239,393
1979/80	251,844	54,280	1,418			307,542
1989/90	304,836	42,388	1,890			349,114
1995/96	268,543	40,344	1,951			310,838
1999/00	264,982	14,895	1,990	5,073		286,940
2000/01	282,482	14,005	2,058	5,013	32	303,590

Grafiku 4.3.2. Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas viteve dhe gjuhës mësimore




Tabela 4.3.3. Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas komunave dhe gjinisë⁶

Nr.	Komuna	Paralele	Numri i nxënësve sipas gjinisë			Mesatarja e nxënësve në paralele
			Meshkuj	Femra	Gjithsej	
1	Deçan	291	3,761	3,471	7,232	25
2	Dragash	264	3,038	2,682	5,720	22
3	Ferizaj	659	9,396	8,545	17,941	27
4	F. Kosovë	162	1,930	1,806	3,736	23
5	Gillogoc	411	5,779	5,286	11,065	27
6	Gjakovë	631	9,202	8,431	17,633	28
7	Gjilan	609	8,345	7,674	16,019	26
8	Istog	275	3,466	3,107	6,573	24
9	Kaçanik	318	3,769	3,433	7,202	22
10	Kamenicë	248	3,029	2,740	5,769	23
11	Klinë	291	4,166	3,625	7,791	27
13	Lipjan	395	5,046	4,540	9,586	24
14	Malishevë	430	5,984	5,289	11,273	26
15	Mitrovicë	508	6,659	6,050	12,709	25
16	Novobërdë	20	175	160	335	18
17	Obiliq	140	1,579	1,394	2,973	21
18	Pejë	599	7,600	7,012	14,612	24
19	Podujevë	647	8,164	7,248	15,412	24
20	Prishtinë	1096	15,217	14,291	29,508	27
21	Prizren	1053	14,294	13,499	27,793	26
22	Rahovec	370	5,417	4,767	10,184	27
23	Skënderaj	405	5,481	4,783	10,264	25
24	Suharekë	479	6,454	5,782	12,236	25
25	Shtërpcë	25	252	191	443	18
26	Shtime	202	2,537	2,250	4,787	24
27	Viti	331	4,456	4,116	8,572	26
28	Vushtrri	463	6,346	5,682	12,028	26

⁶ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

29	Zubin Potok	8	79	110	189	24
Gjithsej		11,330	151,621	137,964	289,585	26

Grafiku 4.3.3. Struktura gjinore e nxënësve në arsimin fillor⁷



Nga tabela 4.3.3 shihet se mesatarja e numrit të nxënësve në paralelet me mësim në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe kroate është 26. Kjo mesatare është më e ulët në komunat më pak të zhvilluara (p.sh. Shtërpcë, Novobërdë). Poashtu, ekziston një raport shumë i balancuar i strukturës së nxënësve sipas gjinive, i cili i përgjigjet strukturës gjinore të popullatës së Kosovës.


Tabela 4.3.4. Numri i nxënësve sipas klasave dhe gjinisë⁸

Klasa	Gjinia		Gjithsej
	Meshkuj	Femra	
I	24,648	22,517	47,165
II	20,482	18,975	39,457
III	18,006	16,783	34,789
IV	18,431	16,945	35,376
V	18,284	16,514	34,798
VI	17,590	15,991	33,581
VII	17,727	15,700	33,427
VIII	16,453	14,539	30,992
I- IV	81,567	75,220	156,787
V-VIII	70,054	62,744	132,798
I- VIII	151,621	137,964	289,585


⁷ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

⁸ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Grafiku 4.3.4. Numri i nxënësve sipas klasave⁹



Grafiku 4.3.5. Numri i nxënësve sipas cikleve¹⁰



Duke i krahasuar grafikët 4.3.4 dhe 4.3.5 me grafikët 4.2.2 dhe 4.2.3 shohim se numri i paraleleve në arsimin fillor sipas klasave është relativisht i përputhshëm me numrin e nxënësve, si në nivel të klasave, ashtu edhe në nivel të cikleve.

Tabela 4.3.6 jep të dhëna mbi numrin e paraleleve në shkollat satelite. Vërehet se paralelet në shkollat satelite përbëjnë 17.7% nga numri i përgjithshëm i paraleleve në Kosovë, ndërsa mësimin në to e vijojnë 12.9% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin fillor në Kosovë. Numri i nxënësve që vijojnë mësimin në shkollat satelite është më i madh në komunat që kanë karakter të theksuar rural. Në shkollat satelite, mesatarja e nxënësve për paralele është 19, pra, dukshëm më e ulët se sa mesatarja kosovare (shih tabelën 4.3.3).

⁹ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

¹⁰ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Tabela 4.3.6. Nxënësit në shkollat satelite sipas komunave¹¹

Nr	Komuna	Shkolla satelite	Gjithsej		Pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të	
			Paralele	Nxënës	Paraleleve	Nxënësve
1	Deçan	5	37	837	12.7%	11.6%
2	Dragash	22	86	1,297	32.6%	22.7%
3	Ferizaj	19	148	3,544	22.5%	19.8%
4	Fushë-Kosovë	13	55	1,068	34.0%	28.6%
5	Glllogoc	3	20	416	4.9%	3.8%
6	Gjakovë	5	15	256	2.4%	1.5%
7	Gjilan	22	98	1,380	16.1%	8.6%
8	Istog	7	33	691	12.0%	10.5%
9	Kaçanik	21	102	1,604	32.1%	22.3%
10	Kamenicë	15	37	513	14.9%	8.9%
11	Klinë	10	77	2,027	26.5%	26.0%
13	Lipjan	26	95	1,780	24.1%	18.6%
14	Malishevë	15	115	2,904	26.7%	25.8%
15	Mitrovicë	13	51	850	10.0%	6.7%
16	Novobërdë	2	0	0	0.0%	0.0%
17	Obiliq	9	51	843	36.4%	28.4%
18	Pejë	13	52	740	8.7%	5.1%
19	Podujevë	26	152	2,781	23.5%	18.0%
20	Prishtinë	24	107	967	9.8%	3.3%
21	Prizren	26	174	2,770	16.5%	10.0%
22	Rahovec	13	75	1,865	20.3%	18.3%
23	Skënderaj	11	75	1,477	18.5%	14.4%
24	Suharekë	15	75	1,477	15.7%	12.1%
25	Shtërpcë	5	23	294	92.0%	66.4%
26	Shtime	11	58	945	28.7%	19.7%
27	Viti	20	102	2,029	30.8%	23.7%
28	Vushtri	20	93	2,013	20.1%	16.7%
29	Zubin Potok	0	0	0	0.0%	0.0%
	Gjithsej	391	2,006	37,368	17.7%	12.9%

4.4. Personeli mësimor – edukativ në arsimin fillor

Personelin mësimor-edukativ e përbëjnë mësimdhënësit, drejtorët, ndihmës-drejtorët dhe pedagogët e shkollave, ndërsa personeli tjetër, pa marrë parasysh përgatitjen shkollore konsiderohet si personel teknik. Mësimdhënësit në arsimin fillor ndahen në dy grupe: mësues, të cilët punojnë në ciklin e ulët dhe arsimtarë, të cilët janë të specializuar për mësimdhënie të lëndëve të caktuara dhe, kryesisht, punojnë në ciklin e lartë. Tabela 4.4.1 jep një pasqyrë të përgatitjes shkollore të kërkuar prej personelit mësimor-edukativ, sipas ligjeve në fuqi.

¹¹ Mingojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Tabela 4.4.1. Përgatitja shkollore e kërkuar prej personelit mësimor-edukativ

Detyrat e punës	Kualifikimi	Përshkrimi
Mësues	Kualifikimi i mesëm	Shkollë e mesme për mësues, p.sh. shkolla normale, akademia pedagogjike
	Kualifikimi i lartë	Shkollë e lartë dyvjeçare e specializuar për mësues, p.sh. SHLP-drejtimi klasor
	Kualifikimi superior	Fakulteti i specializuar për mësues, p.sh. Fakulteti i Mësuesisë, Dega e Pedagogjisë
Arsimtar	Kualifikimi i lartë	Shkollë e lartë dyvjeçare e specializuar për mësimdhënie të 1-2 lëndëve, p.sh SHLP – drejtimet biologji-kimi, matematikë, fizikë-kimi, etj.
	Kualifikimi superior	Fakulteti i specializuar për mësimdhënie lëndore, p.sh. degët e Fakultetit të Filologjisë, Filozofisë, etj.
Drejtor Ndihmës-drejtor	Kualifikimi i lartë	Shkolla e lartë dyvjeçare e profilit arsimor
	Kualifikimi superior	Fakulteti i profilit arsimor
Pedagog	Kualifikimi superior	Fakulteti i specializuar për pedagogji, psh. Dega e Pedagogjisë

Nga tabela 4.4.2 shihet se në shkollat fillore të Kosovës me mësim në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe kroate janë të inkuadruar 17,071 punëtorë, prej të cilëve 14,284 (83.7%) janë mësimdhënës, ndërsa 2,787 (16.3%) nuk janë të inkuadruar drejtpërdrejt në procesin mësimor.

Tabela 4.4.2. Personeli mësimor-edukativ dhe teknik në arsimin fillor sipas komunave¹²

		Mësimdhënës			Personel tjetër mësimor-edukativ			Personel teknik	Gjithsej
		Mësues	Arsimt.	Gjith.	Drejtorë	N.drejt.	Pedag.		
1	Deçan	155	214	369	15	0	0	63	447
2	Dragash	193	144	337	12	0	2	54	405
3	Ferizaj	356	479	835	22	2	0	112	971
4	Fushë-Kosovë	86	132	218	6	0	0	28	252
5	Gllgoc	221	299	520	21	0	0	98	639
6	Gjakovë	339	479	818	36	3	1	127	985
7	Gjilan	358	395	753	19	4	2	98	876
8	Istog	152	170	322	10	0	0	43	375
9	Kaçanik	182	211	393	12	1	0	77	483
10	Kamenicë	127	149	276	12	1	0	50	339
11	Klinë	162	209	371	14	0	0	61	446
13	Lipjan	228	265	493	17	0	0	68	578
14	Malishevë	242	278	520	19	0	0	79	618
15	Mitrovicë	258	380	638	26	0	0	93	757
16	Novobërdë	12	16	28	2	0	0	5	35
17	Obiliq	61	109	170	5	0	0	19	194
18	Pejë	332	434	766	27	1	2	132	928
19	Podujevë	326	507	833	29	3	1	125	991
20	Prishtinë	561	861	1,422	34	2	14	285	1757
21	Prizren	555	818	1,373	40	6	4	197	1620

¹² Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

		Mësimdhënës			Personel tjetër mësimor- edukativ			Personel teknik	Gjithsej
		Mësues	Arsimt.	Gjith.	Drejtorë	N.drejt.	Pedag.		
22	Rahovec	210	223	433	16	2	0	74	525
23	Skënderaj	208	295	503	19	2	0	86	610
24	Suharekë	262	353	615	22	1	1	75	714
25	Shtërpcë	13	13	26	1	0	1	7	35
26	Shtime	114	145	259	7	0	0	35	301
27	Viti	189	223	412	14	1	6	71	504
28	Vushtrri	247	324	571	20	1	0	81	673
29	Zubin Potok	4	6	10	1	0	0	2	13
	Gjithesej	6,153	8,131	14,284	478	30	34	2,245	17,071

Tablea 4.4.3. Raporti mësimdhënës-nxënës në arsimin fillor sipas komunave¹³

Nr.	Komuna	Nxënës	Mësimdhënës	Raporti mësimdhënës/nxënës
1	Deçan	7,232	369	20
2	Dragash	5,720	337	17
3	Ferizaj	17,941	835	21
4	F. Kosovë	3,736	218	17
5	Gilgoc	11,065	520	21
6	Gjakovë	17,633	818	22
7	Gjilan	16,019	753	21
8	Istog	6,573	322	20
9	Kaçanik	7,202	393	18
10	Kamenicë	5,769	276	21
11	Klinë	7,791	371	21
13	Lipjan	9,586	493	19
14	Malishevë	11,273	520	22
15	Mitrovicë	12,709	638	20
16	Novobërdë	335	28	12
17	Obiliq	2,973	170	17
18	Pejë	14,612	766	19
19	Podujevë	15,412	833	18
20	Prishtinë	29,508	1,422	21
21	Prizren	27,793	1,373	20
22	Rahovec	10,184	433	24
23	Skënderaj	10,264	503	20
24	Suharekë	12,236	615	20
25	Shtërpcë	443	26	17
26	Shtime	4,787	259	18
27	Viti	8,572	412	21
28	Vushtrri	12,028	571	21
29	Zubin Potok	189	10	19
	Gjithsej	289,585	14,284	20

Nga tabela 4.4.3 është evidente se raporti mesatar mësimdhënës/nxënës në shkollat kosovare është 20.

¹³ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe


Tabela 4.4.4. Struktura kualifikuese e mësimeve në arsimin fillor¹⁴

Nr.	Komuna	Mësues			Arsimtarë			Gjithsej		
		Të kual.	Të pakual.	Gjithsej	Të kual.	Të pakual.	Gjithsej	Të kual.	Të pakual.	Gjithsej
1.	Deçan	147	8	155	185	29	214	332	37	369
2.	Dragash	132	61	193	107	37	144	239	98	337
3.	Ferizaj	338	18	356	357	122	479	695	140	835
4.	Fushë-Kosovë	78	8	86	99	33	132	177	41	218
5.	Gllgoc	162	59	221	165	134	299	327	193	520
6.	Gjakovë	314	25	339	397	82	479	711	107	818
7.	Gjilan	334	24	358	313	82	395	647	106	753
8.	Istog	137	15	152	141	29	170	278	44	322
9.	Kaçanik	112	70	182	105	106	211	217	176	393
10.	Kamenicë	113	14	127	111	38	149	224	52	276
11.	Klinë	129	33	162	135	74	209	264	107	371
13.	Lipjan	180	48	228	171	94	265	351	142	493
14.	Malishevë	159	83	242	147	131	278	306	214	520
15.	Mitrovicë	239	19	258	255	125	380	494	144	638
16.	Novobërdë	10	2	12	12	4	16	22	6	28
17.	Obiliq	55	6	61	76	33	109	131	39	170
18.	Pejë	316	16	332	370	64	434	686	80	766
19.	Podujevë	249	77	326	343	164	507	592	241	833
20.	Prishtinë	534	27	561	707	154	861	1241	181	1422
21.	Prizren	465	90	555	628	190	818	1093	280	1373
22.	Rahovec	169	41	210	143	80	223	312	121	433
23.	Skënderaj	176	32	208	194	101	295	370	133	503
24.	Suharekë	212	50	262	244	109	353	456	159	615
25.	Shtëpcë	8	5	13	8	5	13	16	10	26
26.	Shtime	83	31	114	81	64	145	164	95	259
27.	Viti	166	23	189	165	58	223	331	81	412
28.	Vushtrri	211	36	247	221	103	324	432	139	571
29.	Zubin Potok	3	1	4	3	3	6	6	4	10
	Gjithsej	5,231	922	6,153	5,883	2,248	8,131	11,114	3,170	14,284

Nga tabela 4.4.4 shihet se 77.8% të mësimeve kosovarë në arsimin fillor janë të kualifikuar, ndërsa 22.2% janë të pakualifikuar, që paraqet një përkeqësim në krahasim me vitin shkollor 1999/2000, kur 80.9% të mësimeve ishin të kualifikuar, kundrejt 19.1% të mësimeve të pakualifikuar.


¹⁴ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Grafiku 4.4.1. Struktura kualifikuese e mësimeve në arsimin fillor¹⁵



Grafiku 4.4.2 dhe 4.4.3 japin informacion mbi përgatitjen shkollore të mësuesve të kualifikuar dhe të pakualifikuar në ciklin e ulët të arsimit fillor. Vërehet se 43.1% të mësuesve kanë të mbaruar shkollën normale, e cila nuk funksionon që nga vitit 1975.


Grafiku 4.4.2. Përgatitja shkollore e mësuesve të kualifikuar në arsimin fillor¹⁶



¹⁵ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe


¹⁶ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Grafiku 4.4.3. Përgatitja shkollore e mësuesve të pakualifikuar në arsimin fillor¹⁷



Grafiku 4.4.4 dhe 4.4.5 japin informacion mbi përgatitjen shkollore të arsimtarëve të kualifikuar dhe të pakualifikuar në ciklin e lartë të arsimit fillor.

Grafiku 4.4.4. Përgatitja shkollore e arsimtarëve të kualifikuar në arsimin fillor¹⁸



¹⁷ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

¹⁸ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

Grafiku 4.4.5.. Përgatitja shkollore e arsimtarëve të pakualifikuar në arsimin fillor¹⁹




Tabela 4.4.5. Arsimtarët e pakualifikuar në arsimin fillor sipas lëndëve²⁰

Lënda	Të pakualifikuar
Kulturë muzikore	79.6%
Gjuhë e huaj	65.4%
Kulturë figurative	62.2%
Edukatë fizike	46.6%
Edukatë qytetare	46.0%
Matematikë	33.7%
Arsimi teknik	26.5%
Fizikë	26.3%
Biologji	21.5%
Histori	20.8%
Kimi	19.3%
Gjeografi	19.0%
Gjuhë shqipe dhe letërsi	16.7%

Nga tabela 4.4.5 shihet se përqindja e arsimtarëve të pakualifikuar në ciklin e lartë të arsimit fillor dallon dukshëm prej lëndë në lëndë. Në tabelën 4.4.6 është dhënë struktura kualifikuese e drejtorëve të shkollave fillore të Kosovës sipas komunave, prej të cilës shihet se 97.5% të drejtorëve kanë kualifikime të duhura.

Tabela 4.4.5. Struktura kualifikuese e drejtorëve në shkollat fillore të Kosovës²¹

Nr.	Komuna	Shk. e mesme	SHLP	Fakulteti	E panjohur	Gjithsej
1	Deçan	0	10	5		15
2	Dragash	0	8	4		12
3	Ferizaj	0	9	13		22
4	F. Kosovë	0	1	5		6
5	Glllogoc	0	13	8		21
6	Gjakovë	1	31	4		36
7	Gjilan	0	10	9		19

¹⁹ Mungojnë të dhënat për mësimin në gjuhën serbe

²⁰ Burim: Departamenti për Arsim dhe Shkencë

²¹ Mungojnë të dhënat për shkollat me mësim në gjuhën serbe

Nr.	Komuna	Shk. e mesme	SHLP	Fakulteti	E panjohur	Gjithsej
8	Istog	1	6	3		10
9	Kaçanik	1	9	2		12
10	Kamenicë	0	9	2	1	12
11	Klinë	0	10	4		14
13	Lipjan	0	6	9	2	17
14	Malisheva	0	13	6		19
15	Mitrovica	1	15	10		26
16	Novobërdë	0	2	0		2
17	Obiliqi	0	2	3		5
18	Peja	0	20	6	1	27
19	Podujeva	0	20	8	1	29
20	Prishtina	0	19	15		34
21	Prizreni	1	35	4		40
22	Rahoveci	0	14	2		16
23	Skënderaj	0	13	6		19
24	Suharekë	1	17	4		22
25	Shtërpce	0	0	1		1
26	Shtime	0	5	2		7
27	Viti	0	9	5		14
28	Vushtri	1	15	4		20
29	Zubin Potok	0	1	0		1
Gjithsej		7	322	144	5	478

Në vazhdim prezantojmë të dhëna që kanë të bëjnë me përvojën e punës të mësimit në arsimin fillor.


Tabela 4.4.6. Përvoja e punës e mësuesve në arsimin fillor sipas komunave²²

